

STATUT

I

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

" B O L E N A " S H . P . K .

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " BOLENA " SH.P.K. (e cila ketu me poshte quhet " SHOQERIA ") eshte themeluar ne baze te Aktit te Themelimit me daten __.02.1997 nga zoti KRENAR KARAFILI, i biri i Selamit, i datelindjes 22.02.1958, lindur dhe banues ne Vlore, me adrese Lagja 28 Nentori, Rr."DESHMORET", Nr 14, (i cili me poshte do te quhet ORTAKU I VETEM).

Kjo SHOQERI ne perputhje me legjislacionin shqiptar e vecanerisht me Ligjin nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", krijohet nga ORTAKU I VETEM per te ushtruar veprimtari te ndryshme sipas parashikimeve te bera ne Aktin e Themelimit apo nga ky STATUT.

Neni 1 - EMERTIMI

SHOQERIA emertohet " BOLENA " SH.P.K.

SHOQERIA eshte person juridik i se drejtes shqiptare dhe zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar si dhe me dispozitat e Aktit te Themelimit dhe te ketij STATUTI.

SHOQERIA do te quhet person juridik dhe do te veproje si e tille duke filluar nga dita e rregjistrimit te saj ne gjykate, ndersa veprimtaria ekonomike fillon me rregjistrimin e saj ne organet tatimore.

Neni 2 - OBJEKTI I SHOQERISE

Objekti i veprimtarise se SHOQERISE eshte :

Operacione dhe transakcione te cdo lloji i tregtimit me importimin, eksportimin, tranzitimin, transportimin dhe tregtimin e mallrave te ndryshme me shumice e pakice ne natyren e produkteve te gatshme, gjysem te gatshme apo te lendes se pare e ne vecanti:

- produkte bujqesore, blegtorale dhe ushqimore ne pergjithesi;
- pajisje elektroshtepiake dhe elektrokulturore;
- pajisje mobilerie, shtepiake dhe zyre;
- konfeksione, metrazhe, piqe alkooolike, duhan, cigare, artikuj industrial e artistike e te tjera mallra te ngjashme me to;
- prodhime farmaceutike, dentare, kozmetike dhe pjese e pajisje elektromjeksore;
- lende te para, materiale, pajisje dhe makineri ne

[Signature]

- industrine ndertimore si dhe makineri, pajisje e pjese kembimi ne pergjithesi;
- karburanteve e lubrifikanteve edhe nepermjet hapjes se pikave te furnizimit me to;
 - cfaredo lloj tjetër malli qe paraqet interes ne realizimin e qellimeve dhe objektit te veprimtarise se se kesaj **SHOQERIE**.

SHOQERIA do te merret

- kryerjen e operacioneve tregtare te sherbimeve komisionere ne te gjitha llojet dhe fushat qe do te paraqes me interes per te;
- kryerja e veprimeve te kembimit valutor nepermjet hapjes se zyrave qe i sherbejne ketij qellimi;

SHOQERIA mund te ushtroje veprimtari te ushqimit social me ane te celjes se lokaleve me natyre kafe-bar, pije freskuese, mengjezore, piceri, restorante etj;

SHOQERIA mund te ushtroje veprimtarine e blerjes, shitjes apo dhenies me qira te pasurive te palujtshme, si banesa, troje etj. nepermjet ngritjes se zyrave perkatese qe do te ushtrojne kete lloj aktiviteti.

SHOQERIA mund te ushtroje veprimtari per dhenien e konsulences teknike ne fusha te ndryshme qe kane lidhje me objektin e veprimtarise se **SHOQERISE**.

SHOQERIA mund te ushtroje edhe veprimtarine e perfaqesimit, te ndermjetesimit apo te lidhjes se kontratave ndermjet subjekteve te ndryshme private apo shteterore, vendase apo te huaja.

SHOQERIA ka te drejten qe, brenda kufijve te parashikuara ne legjislacionin shqiptar, duke perjashtuar cdo qellim spekulativ, te marre pjese ne fitime dhe/ose ne shoqeri te tjera te se drejtes shqiptare apo te shteteve te tjera si dhe te krijoje shoqeri te tjera tregtare me persona e subjekte publike apo private, vendase ose te huaja.

Neni 3 - QENDRA E SHOQERISE


Qendra e **SHOQERISE** ndodhet ne **VLORE** ne adresen Lagja " 28 Nentori ", Rr."Deshmoret", nr 14.

SHOQERIA, me vendim te organeve te saj kompetente, rast pas rasti, do te krijoje, transferoje dhe/ose anulloje seli dytesore, seli administrative, drejtori, filiale, dege, agjensi dhe zyra si ne territorin shqiptar ashtu edhe jashte vendit.

Neni 4 - KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Kohezgjatja e **SHOQERISE** eshte caktuar deri me 31. 12. 2010.

Me vendim te **ORTAKUT TE VETEM**, kohezgjatja e Shoqerise mund te caktohet tej afatit te percaktuar ne paragrafin e mesiperm.



Neni 5 - KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i SHOQERISE eshte 100 000 (njqind mije) leke.

Kapitali themeltar mund te zmadhohet edhe me kontribute ne natyre.

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit themeltar te SHOQERISE behet me vendim te ORTAKUT TE VETEM.

Fondi ne te holla qe vjen nga shlyerja e pjeseve te kapitalit themeltar depozitohet per llogari te SHOQERISE ne Banken Kombetare Tregtare, Dega Vlore.

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar behet me akt noterial.

Neni 6 - VEPRIMET FINANCIARE

Veprimet financiare te SHOQERISE pasqyrohen ne llogarite (kontabilitetin) e saj, duke aplikuar kriteret e dispozitat mbi kontabilitetin e shoqerive tregtare te parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

Neni 7 - BLERJET E SHOQERISE

SHOQERIA disponon dhe gezon pasurite e saj ne perputhje me qellimin dhe objektin e themelimit te saj.

SHOQERIA ka te drejten e blerjes dhe administrimit te pasurive te cdo lloji e natyre si dhe te jape garanci si mjet sigurimi mbi pasurite e saj per permbushjen e detyrimeve qe merr persiper kundrejt te treteve.


Neni 8 - BILANCI DHE FONDET E SHOQERISE

SHOQERIA per ushtrimin e aktivitetit te saj ^{20.02.1997} fondet e saj. Perberja, madhesia e tyre, burimet e krijimit, perdorimi e rregullimi i cdo fondi te vecante vendosen nga ORTAKU I VETEM dhe administratori i SHOQERISE duke respektuar dispozitat perkatese ne fuqi.

SHOQERIA disponon mjetet e saj financiare. Te gjitha detyrimet e mundshme gjate veprimtarise se SHOQERISE do te mbulohen nga fondet perkatese apo fondet rezerve, ose edhe me zmadhimin e kapitalit themeltar. Te gjitha pasurite e SHOQERISE pasqyrohen ne bilancin e saj me vlefte te shprehur ne monedhe shqiptare.

Bilanci dhe llogarite e SHOQERISE perpilohen e mbahen nga Administratori.

Viti financiar (ushtrimori) fillon me daten 1 Janar dhe mbaron me daten 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik.



Neni 9 - ADMINISTRIMI I SHOQERISE

SHOQERIA administrohet nga ORTAKU I VETEM, qe eshte z. KRENAR KARAFILI, i cili perfaqeson SHOQERINE ne marredhenie me te tretet.

SHOQERIA ne te ardhmen mund te administrohet edhe nga nje Administrator, i cili emerohet me vendim te ORTAKUT TE VETEM.

ORTAKU I VETEM mund ti delegoje kompetencat e tij me shkrim ne formen e autorizimit ose me prokure.

Vendimet e ORTAKUT TE VETEM evidentohen ne nje rregjister te vecante.

Neni 10

ORTAKU I VETEM ose administratori ushtrojne te gjitha kompetencat, te drejtat dhe detyrimet per organizimin dhe drejtimin e SHOQERISE te parashikuara nga ky STATUT, Akti i Themelimit si dhe legjislacioni tregtar shqiptar. Ata kane te drejte te kryejne te gjitha veprimet qe i konsiderojne te domosdoshme per realizimin e qellimeve te SHOQERISE, pa cenuar interesat e saj.

Neni 11

ORTAKU I VETEM si dhe administratori pergjigjen per te gjitha veprimtarine e SHOQERISE qe nga momenti i themelimit te saj.

Neni 12 - MARRDHENIET E PUNES

Marredheniet e punes ndermjet SHOQERISE, filialeve e agjensive te saj (nese krijohen te tilla) dhe punonjesve te saj rregullohen me kontraten e punes. Per ceshtje te paparashikuara ne kontraten e punes zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Neni 13 - NDRYSHIMET NE STATUT

Ndryshimet ne Statut mund te behen me vendim te ORTAKUT TE VETEM dhe sipas dispozitave ligjore te parashikuara ne Ligjin "Per Shoqerite Tregtare".

Neni 14 - SHNDERIMI I SHOQERISE

SHOQERIA mund te shnderohet ne nje shoqeri kolektive, komandite apo anonime me vendim te ORTAKUT TE VETEM.

Shnderimi i Shoqerise ne nje shoqeri tjeter do te konsiderohet i vlefshem vetem duke respektuar dispozitat ligjore te parashikuara nga ligji "Per Shoqerite tregtare".

Neni 15 - PRISHJA E SHOQERISE

SHOQERIA priset ne rastet kur ;

- a - mbaron afati i parashikuar ne Aktin e Themelimit;
- b - nuk mund te realizohet objekti i SHOQERISE sipas Aktit te Themelimit dhe Statutit ;
- c - nje vendim te tille e merr ORTAKU I VETEM.

Neni 16 - LIKUIDIMI I SHOQERISE

Likuidimi i SHOQERISE do te behet sipas dispozitave te legjislacionit falimentar shqiptar ne fuqi ne castin e likuidimit.

ORTAKU I VETEM vendos rregullat per proceduren e likuidimit si dhe per personat qe do ti aplikojne ato.

Ne rast prishje te SHOQERISE pasuria e mundeshme qe mbetet pas shlyerjes se te gjitha detyrimeve te SHOQERISE, i mbetet ORTAKUT TE VETEM.

Neni 17 - DISPOZITE E FUNDIT

Ky statut hyn ne fuqi dite e rregjistrimit te SHOQERISE ne Gjykatën e rrethit Tirane.

Ky Statut u njoh dhe u nenshkrua nga ORTAKU I VETEM ne _____ me 20.02.1997.

O R T A K U I V E T E M

KRENAR KARAFILI

20. 02. 1997